



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**A.nr. 865/13**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, dhe me procesmbajtësen Donjeta Culaj, në konfliktin administrativ të paditësit "U." SH.A, të cilin e përfaqëson me autorizim G. A., avokat në P., kundër të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, me datë 05.10.2017, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**Aprovohet** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit "U" Sh.A, të cilin e përfaqëson me autorizim "U" Sh.A, avokat në P.. **Anulohet** aktvendimi i të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me nr. 02/2013, të dt. 27.05.2013, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

### **A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në mungesë palës së paditur, të thirrur në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i paditësit, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, padia është ngritur pranë gjykatës për anulim të vendimit Nr.5632 të dt.27.05.2013, me të cilën ARBK e ka hedhur poshtë si të pasafatshme ankesën e paditësit, duke aluduar se ankesa është e jashtë afatit, ndërsa me shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë se paditësi ankesën e ka dorëzuar në afatin ligjor përmes postës me dt.07.05.2013, për të cilën provat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë vërtetimi i dorëzuar me postë me nr. si ne padi 0357424 i dt.07.05.2013. E paditura qëllimisht ose për shkak të neglizhencës apo kamufllimit të çështjes e ka konsideruar si datë të dorëzimit të ankesës datën kur e njëjta e ka protokolluar në protokollin e brendshëm dhe atë me dt.15.05.2013, dhe për ta konsideruar ankesën si të pasafatshme. Me tutje shton se, vendimi i kontestuar, të anulohet me aktgjykim nga gjykata dhe çështja të kthehet në rishqyrtim të e paditura, me qëllim që ankesa e dorëzuar të shqyrtohet në mënyrë profesionale dhe me seriozitetin me të lartë pasi që në të njëjtën janë cekur të gjitha shkeljet që Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, i ka bërë gjatë pranimit të kërkesës së bordit jo legjitim të U. Sh.A. dhe ka pranuar ndryshimet statutores në kundërshtim me dispozitat ligjore të ligjit mbi shoqëritë tregtare. Në fund shton se, mbetet pranë parashtrimeve si me lartë për anulimin e vendimit të nxjerre nga ARBK me nr.5632 të dt.27.05.2013, me të cilin hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me nr. protokollin 4800 të dt.15.05.2013, e parashtruar nga U. Sh.A. kundër vendimit të Kryeshefit të ARBK-së, me nr. protokollin 329 të dt.25.04.2013, si dhe çështja të kthehet të paditurës për rishqyrtim dhe vendosje.

E autorizuar e të paditurës, në përgjigjen në padi të datës 12.04.2016, e ka njoftuar gjykatën se mbetet në tërësi pranë përgjegjës në padi, duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit "U" Sh.A, t'a refuzon në tërësi si të pabazuar, duke e lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë dhe gjendjen e plotë të fakteve, për të vendosur drejtë në këtë çështje juridike, në seancën e datës 05.10.2017, ka bërë administrimin e provave duke i lexuar: vendimi i dt.27.05.2013 me nr.02-2013;certifikata e regjistrimit e dt.01.02.2010; aplikacioni me nr.70340095; certifikata me numër fiskal 600248167; certifikata me numër 330047911; vendimi i dt.25.04.2013; ankesa e dt.14.05.2013 me nr.362; dokumenti nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të dt. 15.03.2012; regjistri i aksionareve i dt. 24.02. 2012; vërtetimi mbi pranimin e dërgesës së dt.07.05.2013; e-mali-i , i dt.03.05.2017, të orës 02:55; kërkesa për verifikim të shkresës së dorëzuar të dt.05.05.2017, me nr. të dosjes 05-1308/2017 dhe anex statusi i dt.24.02.2012.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të Ligjit të konfliktit Administrativ, pasi vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, vlerësimi të thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë çështje administrative, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga vendimet e kontestuara del se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 paragrafi 2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimet e goditura me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se *"Duke pasur parasysh vendimet e Ministrisë të MMPH-së, siç janë: ankesa me nr. 4800, te dt. 15.05.2013, e parashtruar nga U.i SH.A, është parashtruar jashtë afatit ligjor. Ne baze të dispozitave të Ligjit nr. 04/L0006 për ndryshimin e dhe plotësimin Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqërit tregtare , neni 7 , paragrafi 2 nën paragrafi 10.6, afati për paraqitjen e anekses është 8 ditë. Citojmë se" Nëse Kryeshefi i Agjencisë nuk e shqyrton ankesën apo me vendim refuzon ankesën atëherë parashtruesi i ankesës në afat prej tete (8) ditësh, nga dita e pranimin të Vendimit mund të parashtrorë ankesë të Komisioni për parashtrësia dhe ankesa ne kuadër të MTI-se" dhe neni 11, paragrafi 17.3 citojmë "Pala e pa kënaqur me vendimin e Kryeshefit të ARBK-së në afatin prej tetë (8) ditësh ushtron ankesë në Komisionin për parashtrësia dhe ankesa. Kundër vendimit të Komisionit për Parashtrësia dhe Ankesa pala e pa kënaqur në afatin prej tridhjetë (30) ditësh mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Supreme të Kosovës. Vendimi i Kryeshefit të ARBK-së me nr. protokollit 329 te dt.25.04.2013, është pranuar nga pala me dt. 29.04.2013, kurse ankesa është parashtruar me dt. 15.05.2013".*

Me vendimin e të paditurës Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me nr. 02/2013, te dt. 27.05.2013, është hedhe poshtë si jashtë afatit, ankesa me nr. të protokollit 4800, të dt. 15.05.2013, e parashtruar nga "U" Sh.A, me arsyetimin se ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor.

Nga provat e administruara gjykata ka gjetur se, vendimin e Kryeshefit të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, me nr. te protokollit 329, te dt. 25.04.2013, e pranuar nga pala me dt. 29.04.2013. Ndërsa, afati për parashtrimin ankesës pan komisionit për parashtrësia dhe ankesa në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë, sipas dispozitave të Ligjit nr. 04/L0006, për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, neni 7, paragrafi 2 nën paragrafi 10.6, është përcaktuar në afatin prej 8 ditësh. Sipas, nenit 122 par. (a) të LPA-së, afati fillon të rrjedhë ditën e nesërme të datës kur del akti, andaj në rastin konkret afati ka filluar të rrjedhë me datë 30.04.2013, dhe parimisht ka përfunduar me datë 07.05.2013. Gjithashtu, nga Vërtetimi mbi pranimin e dërgesës postës së Kosovës me nr. të Pranimit 10110 e dt. 07.05.2013, të administruar si provë në këtë çështje juridike, shihet se, paditësja me datë 07.05.2013, e ka dorëzuar ankesën në postë, që nënkupton se ankesa është parashtruar brenda afatit ligjor.

Prandaj gjykata konstaton se në rastin konkret organi i paditur ka shkelur ligjin në dëm të paditëses sepse vendimi i të paditurës, është marrë pa u shqyrtuar drejtë gjendja faktike respektivisht nuk janë marrë për bazë faktet vendimtare lidhur me llogaritjen e afatit e po ashtu nuk është zbatuar drejtë Neni 122 i Ligjit të Procedurës Administrative, i cili përcakton mënyrën e llogaritjes së afateve.

Bazuar në gjendjen faktike të konstatuar, gjykata e obligon organin e paditur që gjatë ri-procedimit, në përputhje me vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim, t'i mënjanojë të metat e cekura dhe të vendosë lidhur me ankesën e paditëses, në mënyrë të drejtë dhe bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura në këtë aktgjykim janë të obligueshme për organin e paditur, në bazë të Nenit 62 të Ligjit të procedurës Administrative.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6 dhe 38 dhe në bazë të Nenit 43.2 dhe 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr. 865/13 data 05.10.2017**

Procesmbajtëse  
Donjeta Culaj

G j y q t a r e  
Luljeta Maxhuni

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa,  
në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit,  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.